



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 19.05.2025

Numër protokolli: 3273/2025

A.nr.515/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani- kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari -anëtarë, me Çlirim Zeka- në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.515/2025 të datës 21.03.2025 të parashtruar nga ankuesi B.K., kundër organit të punësimit Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike “*masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 19.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa më numër A.nr.515/2025 e datës 21.03.2025 e parashtruar nga ankuesi B.K.

II. Mbetet në fuqi njoftimi i datës 24.02.2025 për shqiptimin e masës disiplinore „*Vërejtje me shkrim*”, nga Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit, B.K. i punësuar sipas Akt Emërimit me Nr.1623/2020 të datës 19.05.2024 i cili mban pozitën e punës “Zyrtar për administrimin e Teknologjisë Informative”, në Departamentin e Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datë 24.02.2025, Sekretari i Përgjithshëm i shqipton masën disiplinore “*Vërejtje me shkrim*”.

Ankuesi kundër shqiptimit të masës disiplinore “*Vërejtje me shkrim* të datës 24.02.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 21.03.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1864/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të regjistruar nën shenjë A.nr.515/2025, me pretendim ankimor për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave

të procedurës administrative, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe zbatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 15.04.2024 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ndërsa Këshilli, me datë 24.04.2025 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1864/2024 të datës 21.03.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e letërnjoftimit; Emali i datës 10.02.2025-Vendimi i Komisionit për dosje për Shërbim të Hotelerisë; Emali i datës 11.02.2025; Emali i datës 13.02.2025; Emali i datës 20.02.2025; Emali i datës 20.02.2025-kërkesë për takim; Emali i datës 24.02.2025; Emali i datës 24.02.2025-Kërkesë për takim; Emali i datës 24.02.2025-shqiptimi i masës disiplinore “vërejtje me shkrim”; Vendimi me Nr.124/2025 i datës 07.02.2025 nga Sekretari i Përgjithshëm i MKRS; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 15.04.2025; Përgjigje në ankesë e datës 24.04.2025 nga organi i punësimit; Akt Emërimi me Nr.1623/2020 të datës 19.05.2020 dhe Përshkrimi i detyrave të punës i datës 11.03.2019;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, ***sepse:***

Bazuar në shkesat e lëndës, gjegjësisht Akt Emërimin e datës 19.05.2019 është konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës “ Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informative, të cilit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me datë 24.02.2025 përmes emailit i shqipton masën disiplinore “Vërejtje me shkrim.” me arsyetimin se i njëjti ka kryer shkelje të detyrave të punës të përcaktuar me dispozitat e nenit 56 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Ankuesi më datë 21.03.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1864/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të regjistruar nën shenjen A.nr.515/2025, kundër masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” të datës 24.02.2024 të shqiptuar nga Sekretari i Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me pretendimet ankimore se i njëjti i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit dhe dëshmive të ofruara në lëndë, konstaton se Sekretari i Përgjithshme në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore “Vërejtje me shkrim ndaj ankuesit Z.B.K. ka arritur të vërtetoj drejtë gjendjen faktike dhe juridike duke konstatuar se i njëjti ka kryer shkelje të detyrave të punës të përcaktuar me dispozitat e nenit 56 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët

Publik ku përcaktohet se:” *sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrëset/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun*” dhe për këtë shkelje i është shqiptuar masa disiplinore “Vërejtje me shkrim” bazuar në dispozitat e nenit 57 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe nenit 58 paragrafit 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Nga provat e bashkangjitura nga ankuesi dhe organi i punësimit, Kolegji ka konstatuar se ankuesi ka kryer shkelje të detyrave sepse: Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datë 07.02.2025 ka nxjerr vendimin me Nr.124/2025 për formimin e Komisionit për përpilimin e dosjes dhe specifikave për Shërbime të hotelerisë në MKRS, në këtë komision njëri prej anëtarëve është edhe ankuesi z.B.K., i njëjti me datën 11.02.2025 i ka dërguar një email Sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë duke e njoftuar se nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni me arsyetimin se kam angazhime të shumta dhe përshkrimi i detyrave të mia nuk përkojnë me rolin dhe qëllimin e komisionit në fjalë. Po me të njëjtën datë Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit përmes emailit e ka njoftuar ankuesin se caktimi i tij në këtë komision është valid dhe nuk do të shfuqizohet. Me datë 13.02.2025, R.K ka thirrur takim për datën 18.05.2025 në ora 9.00, me datën 20.03.2025 i njëjti ka thirrur takim për të njëjtën ditë prej orës 13.30 dhe me datën 24.02.2025 z.K. ka thirrur një takim tjetër, ankuesi nuk ka marrë pjesë në asnjë takim. Me datën 24.02.2025 Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë ka kërkuar nga z.K. të raportojë për zyrtarët që nuk marrin pjesë në takime të Komisionit për përpilimin e dosjes dhe specifikave për Shërbime të hotelerisë në MKRS, z.K. ka konfirmuar mungesën e z.B.K., po me të njëjtën datë Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të njëjtit i ka shqiptuar masën disiplinore “vërejtje me shkrim” dhe i është drejtuar Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore për ta vendosur vërejtjen me shkrim në dosjen e ankuesit dhe po ashtu ka kërkuar pjesëmarrjen e detyrueshme e z. K. në komision.

Kolegji konstaton se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore Vërejtje me shkrim të datës 24.02.2023 ndaj ankuesit ka arritur të vërtetoj drejtë gjendjen faktike juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 Për Zyrtarët Publikë respektivisht ka konstatuar shkeljet e kryera nga ankuesi i cili ka bërë shkelje të lehta të detyrave të punës së përcaktuara me nenin 56, paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 Për Zyrtarët Publikë, , ku theksohet se: “ 1. Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësisive të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 2. Shkeljet e rënda të detyrave dhe përgjegjësisive të punës janë të përcaktuara me ligj, ndërsa shkeljet e lehta janë të përcaktuara me ligj dhe rregulla të brendshme. 3. Shkelje të lehta konsiderohen: 3.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 3.2. mosrespektimi i orarit të punës; 3.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrëset/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun;”, gjegjësisht i ka shqiptuar masën disiplinore duke cilësuar veprimet e tij se përbejnë shkelje të lehta të detyrave të punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke marr parasysh shkeljet ligjore dhe procedurale në këtë procedurë disiplinore konstaton që masa disiplinore vërejtje me shkrim është shqiptuar në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr. 01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.515/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit B.K.;
- Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.